

## MBROJTJA E TËRËSISË KOMBËTARE SHQIPTARE SIPAS KËNGËVE ME TEMATIKË HISTORIKE

*Fazli Syla*

KUD 398.8:949.65  
949.65:398.8

Prishtinë

Marrë për botim më 15 tetor 1993

Përmbajtja e shkurtër: E gjithë e kaluara e popullit shqiptar përshkohet nga përpjekjet e luftërat e vazhdueshme për ruajtjen e tërësisë kombëtare e territoriale shqiptare nga pushtuesit e ndryshëm. Shquhen veçanërisht luftërat dhe pushtimet e shteteve fqinje ballkanike, që po vazhdojnë deri në ditët e sotme. Në gjithë kontinuitetin e tyre këto ngjarje e luftëra për mbrojtjen e tokave shqiptare i ka transponuar artistikisht epika jonë gojore me tematikë historike, duke krijuar, në këtë mënyrë, një lëndë të çmueshme të trashëgimisë shpirtërore të popullit shqiptar.

Populli shqiptar gjatë gjithë historisë, veçanërisht prej mbarimit të shekullit të kaluar e deri në ditët e sotme, bëri përpjekje të mëdha për ruajtjen e integritetit kombëtar e tokësor. Mirëpo, si popull më i rrezikuar, i torturuar, i masakruar e i gjymtuar në Evropë, edhe fatin historik e pasojat e tij do t'i ketë të disfavorshme.

Ndjenja e rrezikimit të ekzistencës kombëtare dhe e rezistencës gjithnjë prezente në vetëdijen kombëtare, janë shprehur shumë edhe në gjithë krijimtarinë shpirtërore, posaçërisht në epikën historike, me një shtrirje të gjerë në të gjitha trevat shqiptare, por me një prani më të madhe në ato treva, që lidhen drejtpërdrejt me ngjarjet historike dhe ku ato ngjarje ishin më të egra dhe më të kobshme për kah pasojat e tyre në realitetin historik.

Lakmitë e mëdha të fqinjëve grabitçarë, ndasitë fetare me tri qendra jashtë vendit, aversioni i evropianëve ndaj pjesës së islamizuar të shqiptarëve, siç e quanin pykë e keqe në trungun e shëndoshë të Evropës krishtere, koalicionet e ndryshme evropiane sllavo-ortodokse dhe ato të

luftës për ndikim, si ai gjerman, anglez e francez, kanë bërë që në të gjitha tubimet ndërkombëtare, ku vendosej fati i kombeve, dikur në Perandorinë Osmane, të mos kenë qëndrim të drejtë ndaj shqiptarëve, rrjedhim i të cilit është ndarja e tokave dhe e popullit shqiptar në pesë shtete.

Ky fat historik, i përshkuar me luftëra të vazhdueshme për liri, pavarësi, bashkim kombëtar, deri te luftërat për ekzistencë individuale dhe për mbrojtje të tërësisë territoriale e kombëtare nga synimet grabitçare e shfarosëse të të tjerëve në hapësirën e Ballkanit, ka bërë që rrjedha e ngjarjeve historike të shqiptarëve të jetë më dinamike, më tronditëse dhe më dominante në jetën e popullit tonë dhe në historinë e tij të shprehur në vargjet e letërsisë gojore.

Është plotësisht e kuptueshme pse këngët për luftërat shqiptaro-serbomalazeze lidhen më shumë me epikën historike të Veriut në përgjithësi dhe me atë të Kosovës në veçanti, ndërsa ato shqiptaro-greke me Jug dhe Çamëri, pra me krahët e thyer të shqipes.

Me disa oscilime e pengesa të natyrës politike, kësaj krijimtarië iu kushtua kujdes mjaft adekuat me vlerën e saj historike e artistike, në të gjitha botimet e para dhe të Pasluftës, me një sistemim më të mirë në korpusin «Epika historike»<sup>1</sup> dhe «Epikë historike kosovare»<sup>2</sup>. Përjashtim bëjnë botimet në territorin e Jugosllavisë së Pasluftës, ngase tematika e tyre ishte temë tabu, që sipas politikës së ngurtë partiako-shtetërore totalitare e rrezikonte vëllazërim-bashkimin dhe tendencat për t'i qitur në harresë pasojat e politikës hegjemoniste e çkombëtarizuese serbomalazeze e maqedone kundër shqiptarëve, për të asgjësuar krijimtarinë kulturore kombëtare dhe për ta përfshirë popullin shqiptar në proceset integruese jugosllave, shprehje kjo eufemiste për përpjekjet asimiluese prezente që tetëdhjetë vjet në viset që mbesin jashtë territorit të shtetit kombëtar shqiptar. Kësaj duhet shtuar edhe ndikimin e disa kritereve absurde ideologjike e klasore rreth traditës kombëtare të pranishme për një gjysmë shekulli në botën shqiptare.

Përmbledhja «Epikë historike kosovare» përfshin këngët e të gjitha viseve shqiptare të Kosovës, të Kosovës Lindore, të Maqedonisë e Malit të Zi, sepse këto, të mbetura jashtë trungut shtetëror shqiptar gravitojnë kah pjesa tjetër homogjene e ndarë nga tërësia, gjë që ka bërë që emri i Kosovës të përdoret shpesh për të gjitha trevat shqiptare në ish-Jugosllavi<sup>3</sup>.

1 *Epika historike, 1*, Instituti i Kulturës Popullore Tiranë, (përgatitur nga Q. Haxhihasani), Tiranë, 1981.

2 *Epikë historike kosovare*, Instituti i Kulturës Popullore, (përgatitur nga Qemal Haxhihasani e Agron Xhagolli), Tiranë, 1985.

3 *Po aty*, parathënia, f. XVIII.

Përmbledhja «Këngë popullore nga Çamëria»<sup>4</sup> rrëfen për rrethanat dramatike historike e politike në Çamëri. Ato për kah ashpërsia e terrorit që bëhet mbi këtë popullsi janë edhe më të rënda, dhe si rezultat kanë gjendjen e sotme, të kësaj treve dhe fatin e keq të çamëve.

Epika historike në përgjithësi dhe ajo kosovare me këtë tematikë, është mbledhur në mënyrë të organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, është sistemuar dhe është botuar herë pas herë në mënyrë parçiale, por asnjëherë në tërësi, për arsye të pasojave që do të mund t'i kishte Instituti, individët realizues të projektit, apo për shkak të gjymtimeve që do t'i impononte seleksionimi i botimit. Tani ato do ta shohin dritën, si dy apo tri vëllime të këngëve historike të mbledhura në trevat shqiptare të mbetura në Jugosllavi, e që si të tilla, mbase do të jenë edhe botimet e fundit të trajtimit jointegral të trashëgimisë kulturore.

Në vargjet e kësaj poezie paraqiten periudhat e ndryshme historike, që nga luftërat kundër sundimit turk, luftërat pushtuese ballkanike, kur çdo kush përpiquej të pushtojë sa më shumë e të ngulë hunj, duke vënë kufij, luftërat çlirimtare, si ajo që e kemi quajtur nacionalçlirimtare, të gjitha format e terrorit që kanë për qëllim final shpërnguljet e shqiptarëve nga trojet e tyre dhe krijimin e territoreve të pastra etnike sllavo-ortodokse ose greko-ortodokse, roli i Fuqive të Mëdha, veçmas i Rusisë, në të gjitha kohërat në favor të sllavo-ordodoksisë-politike që po vazhdon edhe sot, pastaj viset e ngjarjet me ndikim vendimtar në rrjedhat e historisë sonë kombëtare.

Sa më shumë që dobësohej Perandoria Osmane në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, aq më shumë shtoheshin apetitet ekspansioniste të fqinjëve për pushtimin e tokave shqiptare. Meqë në këtë dobësim rol vendimtar kishte Rusia, e cila në vitin 1878 i afrohet Stambollit<sup>5</sup>, trimërohen ushtritë serbe, malazeze, bullgare, maqedonase e greke. Në fillim duke dalur në territorin nën sundimin turk për të bërë krime mbi shqiptarët, si paralajmërim për atë që i pret pas pushtimit, për çka ofron të dhëna kënga e Demë Ahmetit<sup>6</sup> e më vonë duke sulmuar Toplicën, Plavën, Gucinë, Krajën, Anamalin, Tivarin, Ulqinin deri në afërsi të Shkodrës.<sup>7</sup>

Kjo është koha e hovit të madh të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, kur ishte formuar një vetëdije e lartë kombëtare, kur duhej luftuar në dy fronte, kundër sunduesit shekullor dhe kundër fqinjëve ballkanikë, që i

4 *Këngë popullore nga Çamëria*, Instituti i Kulturës Popullore, (mbledhur e përgatitur nga Fatos Mero Rrapaj, Tiranë 1983.

5 *Historia e popullit shqiptar, II*, grup autorësh, ribotim i Entit të Teksteve e Mjeteve Mësimore të Kosovës, Prishtinë, 1969, f.116.

6 *Epika historike, I*, f.394.

7 *Historia e popullit shqiptar, II*, f.116.

kërcënoheshin vazhdimisht tërësisë tokësore të trevave shqiptare me robëri të re shumë më të tmerrshme dhe shfarosëse, sepse edhe qëllimet dalin të ndryshme. Derisa të e para kemi të bëjmë me pushtim klasik, pushtuesit e rinj synojnë zhdukjen apo eliminimin e tërësishëm të shqiptarëve nga trojet e tyre shekullore për të krijuar shtetet e tyre të pastra në pikëpamje etnike e fetare.

Për rolin e Evropës në këtë kohë, për Kongresin e Berlinit, për pozitën inferiore të Turqisë dhe superiore të Ruisë, e cila dikton rrjedhën e ngjarjeve, flasin vargjet:

*Krejt Evropa n'kamë janë çue,  
N'at Berlin janë vajtë, janë shkue,  
Krali i Rusit n'kamë na u çue,  
Keq ka nisë me diskutue,  
Babës mret ju ka ngërmue:  
- Cërrnagoren m'e zgjanue,  
Shumë e vogël a qillue,  
Hot e Grudë, Plavë e Gusi,  
Me ja lshue Malit të Zi!<sup>8</sup>*

Kështu vijnë urdhrat edhe për dorëzimin e Plavës, të Gucisë, të Ulqinit, të Kosovës, të trevave shqiptare në Maqedoninë e sotme dhe të Çamërisë.

Të shumta janë vargjet ku qahet fati i Kosovës dhe i viseve të tjera me të njëjtin fat, mallkohen ata që i kontribuan një ngjarjeje të tillë me politikën e padrejtë të tyre, duke e sakatuar trungun shqiptar për të mos u mëkëmbë më qe më se një shekull. Kjo politikë mbetet prorë prezente në këto troje të rrahura nga erërat e Ballkanit të trazuar. Kënga që vijon u kushtohet vendimeve famëkeqe të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 1913:

*Të mëdhenjt paçin belanë,  
që e trazuan dynjanë,  
mëmëdhen' më dysh na ndanë,  
Kosovën jasht'na e lanë.<sup>9</sup>*

Por, me gjithë terrorin, ekzodet dhe përpjekjet e parreshtura për asimilim ose eliminim, uniteti shpirtëror mbeti i pathyeshëm, bile mund të thuhet se bëhet gjithnjë më i theksuar. Në vargje thuhet:

<sup>8</sup> Arkivi i Institutit Albanologjik të Prishtinës, (dosja: këngët historike).

<sup>9</sup> *Epika historike*, 3, Instituti i Kulturës Popullore, (përgatitur nga Qemal Haxhihasani e Miranda Dule), Tiranë, 1990, f.44.

*Moj Evrop' moj shtrig' e zezë,  
ndave shqipen në dy pjesë,  
ndave djepa, ndave vorre,  
po një gja ti e harrove:  
S'dahet zemra me gurë kufini,  
S'ka traktat që e ndan shpirtin.*<sup>10</sup>

Kënga popullore gjithnjë ka njohur vetëm tërësinë tokësore shqiptare, duke mos i pranuar kufijtë që e prenin atë. Për te të gjitha këto vise janë vetëm Shqipëri, si në vargjet:

*Tym e flakë në atë Kumanovë,  
ushtrisë serbe - ndal - po i thonë,  
s'asht kollaj me hy n'Shqipni,  
as me top, as me singi,*<sup>11</sup>

Duke qenë i vetëdijshëm çka sjell robëria e re, populli kudo bënte rezistencë, prandaj edhe poezia gojore lidhur me të ishte plot barut, sakrifica e viktima dhe përpjekje për përjetësimin e trimërisë së individëve, të viseve dhe të popullit shqiptar në përgjithësi.

*Ç'jan' kto gjam' ç'i po i bjen era?  
- Po liftojn' Rugova e Peja,  
na u ka rras' shkau te dera!*<sup>12</sup>

Këndohet edhe roli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, rezistenca e saj, ndërkombëtarizimi i çështjes shqiptare në suaza evropiane, organizimi në planin ushtarak e diplomatik dhe nevoja për t'u dalë zot tokave shqiptare:

*Ti moj Lidhja shqipëtare,  
tunde male e tunde krale,  
tunde Evropën e madhe,  
që nuk na peshonte fare,  
dhe na pandehte bravare,  
për t'u shitur në pazare,  
tok me lëkur' e lendinë,  
për të kënaqur Serbinë,  
Malëzinë edhe Greqinë.*<sup>13</sup>

10 *Po aty*, f.103.

11 *Po aty*, f. 100.

12 *Epikë historike kosovare*, f.137.

13 *Këngë popullore nga Çamëria*, f.557.

Në momentet vendimtare për kombin shprehet solidariteti i të gjitha viseve, që nga Kosova deri në Çamëri, me aktivitetet e Lidhjes, me programin e udhëheqjen e saj për t'iu kundërvënë të huajve, si:

*Tahir Meta në Mazrek,  
gruas i thotë: - Jamanet,  
jamanet bilat dhe djelt,  
se do shkoj në Prezeren,  
do të tok me Abdul Bejnë,  
se greku me Karadaknë,  
duan vendin të na e marrnë.*<sup>14</sup>

Numërohen popujt me pretendime pushtuese dhe rënia prej duarve të një pushtuesi në tjetrin, si:

*Tek po vin'katër kralli:  
Karadaku me Serbi,  
hem Junani me Bullgari.*<sup>15</sup>

Në këngët çame këndohet lufta në Grebenë (1854), lufta në Lëkurës (1878) dhe ajo në frontin e Llurit (1897) kundër forcave greke, të cilat donin t'i pushtonin tokat shqiptare. Në fund, zakonisht, shprehet vendosmëria për mbrojtje:

*Le ta dijë gjithë Evropa:  
nuk bëhemi copa-copa,  
për serbër, grekër, bullgarë,  
se na jemi shqipëtarë,  
barutin me dhëmbë e hamë!*<sup>16</sup>

Ndër këngët e kësaj periudhe, që u zënë vend të dalluar në epikën tonë historike me temë lufte për tërësinë tokësore shqiptare, janë ato ku këndohet mbrojtja e Plavës, Gucisë, Hotit, Grudës, Ulqinit e Tivarit, të cilat, sipas vendimeve të Kongresit të Berlinit, Turqia duhej t'ia dorëzonte Malit të Zi. Bëhet fjalë, po ashtu, për shkaqet e qëndrimit të tillë të Turqisë, për rezistencën, për kompaktësinë kombëtare, e cila manifestohet me pjesëmarrje në luftëra të luftëtarëve nga Kosova, Shkodra,

<sup>14</sup> *Po aty*, f.568.

<sup>15</sup> *Epikë historike kosovare*, f.354.

<sup>16</sup> *Këngë popullore nga Çamëria*, f.556.

Malësia e Gjakovës e viset e tjera shqiptare dhe për beteja të përgjakshme dhe të pabarabarta.

*I madh e i vogël tan'janë çue,  
tan' kah Plava kan' tfillue,  
i pari t'mbramin hiq s'po e pret.*<sup>17</sup>

Disa herë theksohet se Turqia vepron ashtu pse «ka Stambollën muhasere»<sup>18</sup>, ose «Për me pshtue ni vilajet, /Mos me dhanë tokën e vet».<sup>19</sup> ose pse:

*kështu urdhnnon Car'i Ruisë,  
të shtat'krajlat e Evropës,  
me sulltanin e Turqisë.*<sup>20</sup>

Të tilla janë *Kanga e luftës së miletit, Kanga e Kalasë së Tivarit, Lufta që bani Plavë e Guci*, këngët për Ali pashë Gucinë etj. Përshkruhen luftërat, kërcënimet e knjazit të Malit të Zi dhe të prijësve ushtarakë të tij, si Mark Milanit etj., betejat, viktimat dhe dëmet që i shkaktohen armikut, si:

*Vishegradi po ban seri:  
- Kah p'e bjen Limi gjithë kët nieri?  
- Mark Milanit ju prenë asqeri,  
N'Lim ja myti Jakup Feri.*<sup>21</sup>

E tillë është edhe kënga *Ç'janë këto gjamë që po i bjen era*, ku këndohet Lufta e Nokshiqit.

Luftërave që zhvillohen dhe atyre që vijojnë pas u paraprijnë kushtrimet dhe vendosmëria për qëndresë, si:

*sot për ne ka ardh'një ditë,  
me qendruë për Shqipni,  
mos me lëshue Plav'e Guci,  
i madh e i vogël për pa u shkri!*<sup>22</sup>

17 *Epikë historike kosovare*, f.129.

18 *Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, (përgatitur nga Shefqet Pllana, Rrustem Berisha e Sadri Fetiu), Prishtinë, 1978, f.199.

19 *Po aty*, f. 200.

20 *Epikë historike kosovare*, f. 148.

21 Arkivi i Institutit Albanologjik.

22 *Epikë historike kosovare*, f.148.

dhe vazhdon:

*pa dal'fare soj i shqiptarit,  
nuk zbatohet urdhni i Carit,  
as i Sulltanit të Turqisë,  
i Bizmarkut të Gjermanisë,<sup>23</sup>*

ose:

*-Aferim mori Shqipni,  
t'bukur nam kam nie për ty:  
"Ke lidh'besën për m'u shkri,  
mos me lëshu Plav'e Gusi.<sup>24</sup>*

Pretendimet territoriale të Malit të Zi për tokat shqiptare janë të mëdha dhe shprehen në vargjet e këngës *Lufta e Malit të Zi për Plavë e Guci*, në kërkesën e knjazit drejtuar sulltanit:

*Due me më falë Shkodër e Malci,  
Due me më falë Plavë e Guci,  
E due me më falë Pejë e nahi.<sup>25</sup>*

Shkodra është cak i synimeve të Malit të Zi, të cilën e sulmon shumë herë gjatë dhe pas sundimit turk, si më 1913 e 1920. Ky fqinj verior me aksione të koordinuara me Serbinë ose në bashkëveprim me të, kërkon tërë veriun e Shqipërisë. Në këto rrethana atdheu thërret në mbrojtje:

*- Kush asht trim në fush' t'mejdanit,  
Sot t'i dalin zot vatanit,  
për në Shkodër turravrap,  
të luftojm' me Karadak,  
ta përzejm' prej Shqipnisë,  
Shumadijen e Serbisë,  
Krajl Nikoll'n e Malit t'Zi.<sup>26</sup>*

Këndohet rrethimi i Shkodrës, presioni, izolimi, uria, viktimat në qytet e rrethinë, rezistenca dhe kokëçarjet e vazhdueshme që vijnë nga veriu.

<sup>23</sup> *Po aty*, f. 149.

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 120.

<sup>25</sup> *Zana popullore*, (prej Kasem Taipit), Shkodër, 1933, f.120.

<sup>26</sup> *Epika historike* 3, f.61

*Gjithmonë Shkodra me këto halle,  
Kurr nuk pati rehati,  
I shkoi moti nëpër male,  
Tue luftue me Mal të Zi.<sup>27</sup>*

Serbia dhe Mali i Zi, edhe pse shtete të veçanta, në planin antishqiptar, si edhe sot, gjithnjë paraqiten së bashku.

Pushtimet serbomalazeze përcillen me vrasje, me terror të egër, rrënimë, djegie e plaçkitje. Një pamje të tillë ofrojnë vargjet:

*N'Qaf' t'Morinës qielli krisi,  
Malsin' msyni Veshoviqi<sup>28</sup>  
dymbëdhet' dit' nata s'u err,  
dymdhet'dit' e dymdhet' net,  
Veshoviqi me serbiakë,  
don me mbyt' Tropojën n'gjak,  
Veshoviqi me Mal t'Zi,  
don me ndue kufin' në Dri.<sup>29</sup>*

Kënga e përcjell pushtimin e Kosovës në kohën e luftërave ballkanike, të qyteteve të saj, të Pejës, të Prizrenit, me tendencë shtrirjeje kah Jugu, duke ushtruar terror të posaçëm në Lumë, ku është e njohur beteja e Kolesjanit afër Peshkopisë më 1912 dhe ku, sipas të dhënave historike dhe këngës, të dy palët pësojnë humbje të mëdha.

*N'kulla t'Lumës dymdhet'mi,  
i ke lan' ti moj Serbi.<sup>30</sup>*

Pushtuesit serbë në përpjekjet për të vendosur pushtetin e vet, pos terrorit të paparë, përpiqen të mohojnë etnogjenezën dhe traditën kombëtare shqiptare, njësoj siç bëjnë edhe sot në Kosovë, duke pyetur e duke u përgjigjur vetë. Në këngën «*Hasan Muglica del në lamë*», hoxhës së rrethuar i drejtohen:

*Jetën tande n'daç me e pshtu,  
veç një fjal' ti me na thanë:  
Ktu Shqipni ni her' s'ka qanë!*

27 Zana popullore, f.117.

28 Prijës ushtarak serb i njohur për krime.

29 Epika historike, 3, f. 103.

30 Po aty, f.74.

*Hoxh' Muglica asht ngushtu,  
po komandarit i ka thanë:  
- Po ndigjo ti more dushman,  
në kët vend qi un' po bi,  
ka qen' asht do t'jet' Shqipni.*<sup>31</sup>

Ndërsa në këngën «"Ditn' e han' m'sahati tetë» bëhet fjalë për luftën kundër forcave serbe, të cilat përpiqen të pushtojnë Steblevën në rrethin e Dibrës në vitin 1920.

Në mes të dy luftërave botërore në Jugosllavi krijohet pushtet militarist ushtarako-policor, çfarë vazhdon të jetë edhe sot, me njësi paramilitare bashibozukësh të udhëhequra nga kriminelët e njohur të kësaj kohe Savë Llazari - Batarja, Miliq Kërstiqi, Stojan Domoroci, Gjuro Dollci etj. Për radhët e tyre kërkoheshin njerëz të prirur për krime «zabit te pamerahmet/, qi grin thmi e rob qi vret».<sup>32</sup> Përballë tyre këndohen personat e dalluar nga rezistenca, si Shaban Mustafa, Rexhep Sokoli, Selman Kadria etj.

Pushteti serb, në bazë të projekteve e dokumenteve për eliminimin e shqiptarëve nga trojet e tyre, që nga viti 1843-4 e këndej bën presion për shpërngulje, prandaj edhe terrori është permanent e i programuar:

*Shkit' e kralit janë çu' peshë,  
Vrasin, presin, krejt tu keshë;  
Me faj, pa faj, hiç nuk vesin,  
Shiptart dajma n'besë i presin.  
Na çet shkavi n'borë e n'shi,  
Do pi therrin me singi.*<sup>33</sup>

Masë e pastrimeve etnike ishte edhe e ashtuquajtura reformë agrare, që kishte për qëllim t'ua merrte tokën shqiptarëve për t'ua dhënë serbëve e malazezve, për të realizuar programin e kolonizimit dhe të serbizimit të Kosovës.

*Me zor tokën na merr agrari,  
Për ditë na rreh shka xhanari,  
Me shku n'mal na ze shumari,  
Gjithmon faji te shqiptari.*<sup>34</sup>

31 *Po aty*, f.74.

32 *Po aty*, f.493.

33 Arkivi i Institutit Albanologjik.

34 *Po aty*.

Ose:

*Po ju thot Jagoshi i zi,  
N'katër anët me ndu devri,  
Kur t'vin shiptart në jaci,  
Hudhni bombat në xhami,  
Mloni ftyrat me shami,  
Shiptart duhet krejt faru,  
Hi e pluhun mej maru.<sup>35</sup>*

Krahina shqiptare e Çamërisë, apo krahu jugor i Shqipërisë ka rrjedhë historike të ngjashme me viset e tjera që mbesin jashtë shtetit shqiptar, por me një epilog edhe më të keq për popullsinë çame. Është ky vis që shekuj me radhë i rezistoi pushtimit osman, që u sulmua e u provokua shumë herë nga bandat greke, veçanërisht rreth viteve 1854 dhe 1877, të cilave çamët iu kundërvunë vendosmërisht.<sup>36</sup> Me vetëdije të lartë kombëtare, çamët inkuadrohen në radhët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e të luftërave të mëvonshme, frytet e të cilave gjithnjë i shfrytëzoi pala greke, kështu që edhe pas luftërave ballkanike vërshojnë forcat greke.<sup>37</sup>

Konferenca e Ambasadorëve e Londrës (1913) e vulosi edhe fatin e çamëve, prandaj ata këtë e përjetuan rëndë, e kënduan, e vajtuan dhe i ndien pasojat në qenien e tyre kombëtare. Në epikën historike të kësaj kohe shprehet fuqishëm revolta për copëzimin e hapësirës kombëtare shqiptare, prandaj në shumë këngë hasim vargje, si këto:

*Këta kralet evropianë,  
në male përmbi Sajadhë,  
vunë një nishan të bardhë,  
për të dhezur shamatanë,  
Shqipëria me Junanë,  
Çamërin' e lan mënjanë,  
dhe Kosovën në Serbianë<sup>38</sup>.*

Çamëria, po ashtu, i ka periudhat e theksuara të terrorit e dhunës që lidhen me vitet 1878-1920, 1922-1925, pastaj me vitet 1944 dhe 1949, që përcillen me terror, vrasje e masakra, e që mund të krahasohen me ato që po ngjajnë në Bosnjën e sotme. Kjo dhunë bëhej me qëllim të shndë-

<sup>35</sup> Po aty.

<sup>36</sup> Fjalori enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë, 1985, f.149.

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> Po aty, f. 627.

rrimit të Çamërisë në territor të pastër grek e ortodoks. Për këtë qëllim shfrytëzohet edhe përçarja fetare, si dhe tash. Një pjesë për t'i dëbuar si «turq», siç i quanin myslimanët, kurse të tjerët për t'i asimiluar dhe për t'i vënë në shërbim të pushtuesit. Prandaj, ndjenja e përkatësisë kombëtare theksohet kudo edhe në çdo rast, si përgjigje ndaj politikës së pushtuesit. Poezia epike çame është plot këso vargjesh:

*Çamët nisë t'i përçajnë,  
në kristian' e muslimanë,  
që në mes të futnin zjarrë.<sup>39</sup>*

Ose:

*Çamët u ngrënë e thanë:  
- S'jemi turq, po shqipëtarë,  
dhe nuk e lëmë vatanë,  
na e lanë gjyshrit tanë.<sup>40</sup>*

Ose:

*Erdhi Zerva i vu zjarrë,  
e dogji e bëri hi,  
shtatëdhjet' e ca të vrrarë,  
gra pleq e çilimi,  
seç i theri posi shqerra,  
se s'mohuan kombësi,  
thanë: - Jemi shqipëtarë,  
si në gjithë Çamëri.<sup>41</sup>*

Të tilla ishin edhe përgjigjet e komisioneve dhe të misionarëve të ndryshëm, që delnin për të agjituar për realizimin e marrëveshjes greko-turke, të ngjashme me atë serbo-turke, apo jugosllavo-turke për shpërnguljen e shqiptarëve.

Terrorit i paraprijnë kërcënimet, që na duken të ngjashme e gati identike me këto të sotmet në Kosovë.

*-Ju çamët jini të liq!  
Ju nuk e doni Greqinë,*

39 *Po aty*, f. 697.

40 *Po aty*, f. 660.

41 *Po aty*, f.706.

*po kërkoni Shqipërinë.  
Ne në pashkët që do bijmë,  
si shqerra do u therimë,  
pleq e plaka do i vrasim,  
vajza e nuse do i pagëzojmë.*<sup>42</sup>

Këngët historike çame na sjellin para pamjeve të tmerrshme të masakrimit masiv të popullsisë shqiptare nga forcat shoviniste greke, veçanërisht ato që lidhen me ekspeditat e bandave monarko-fashiste të Zervës.<sup>43</sup>

*Zerva ushtrinë dërgoi,  
parganjotë i bashkoi,  
në mejdani, në kala,  
i mbloodhën burra e gra.  
Zervistat mizeri,  
seç u hodhën si stihë,  
u hodhën bi burra e gra,  
mbushën vendin gjakëra.*<sup>44</sup>

Ose:

*Ç'bën edhesët<sup>45</sup>  
në vent tënë,  
në botë nuk ishte bërë,  
Vranë Çamërin' të tërë,  
prenë glishtat për ohnaza,  
u derdh mbi gra e vajza.  
Bënë edhesët si deshnë,  
shkulën dhe vathët ka veshët,  
burrave u vunë plumbnë  
dhe ca i dogjën në furrë.  
Ca me thika na i therë,  
Çamëri, o moj, e mjerë,  
të dogjnë, të bëjnë hi,  
s'harrohet ajo kërrdi!*<sup>46</sup>

Ngushtimin e tërësisë tokësore shqiptare pushtuesit e realizojnë me shpërngulje, me pastrime etnike e kolonizim, duke filluar në mënyrë

<sup>42</sup> *Po aty*, f. 691.

<sup>43</sup> Napoleon Zerva, prijës i forcave monarko-fashiste greke, që masakruan popullsinë çame në vitet 1943-1944.

<sup>44</sup> *Këngë popullore nga Çamëria*, f.703.

<sup>45</sup> Pjesëtarë të organizatës fashiste Edhes, që udhëheqej nga Zerva.

<sup>46</sup> *Këngë popullore nga Çamëria*, f. 701.

masive me ekzodin e muhaxhirëve, me ato të Plavës, të Gucisë, të Tivarit e të Ulqinit, pastaj nga Kosova, Maqedonia, Çamëria, me intensitet të ndryshëm sipas periudhave të viteve kritike, duke vazhduar deri në ditët tona. Megjithatë, shpërnguljet më të furishme e rrënjësore lidhen me ekzodin e muhaxhirëve dhe atë të Çamërisë, që kanë bërë që territori i Toplicës të mbetet plotësisht pa shqiptarë, kurse në Çamëri na mbetet vetëm e drejta historike përballë një realiteti shumë të hidhur. Këto edhe janë faqet më të errëta të historisë sonë kombëtare. Vargjet na sjellin përpara kolonave të tmerrit e të vdekjes, të cilat, mjerisht, edhe sot janë dukuri që i hasim përpara ekspeditave barbare të disa qarqeve sllavo-ortodokse. Ja se ç'thonë vargjet për marshet e turpit të Evropës që nga mbarimi i shekullit të kaluar e deri më sot:

*Oh muhaxhirt kan' marr' dyjan' n'sy-e,  
desin n'bor', o bre, desin në shi-e,  
desin pleq, o bre, desin t'ri-e,  
desin gra, o bre, desin thmi-e,  
u desin thmija, bre, nanav' n'gji-e,  
jesin gjenazet, bre, n'vorre pa i shti-e!  
Bukë pa ngran', o bre, uj' pa pi-e,  
kan' mrrë udhën, bre, për Albani-e;  
oh, udhën e gat', o bre, për Turki-e!<sup>47</sup>*

Dhe një pamje tjetër nga Çamëria:

*pashë Çamërinë djegur bërë hi:  
grat' e Çamërisë me foshnja në gji,  
pa këpucë dhe pa shami,  
zunë rrugën o për në Shqipëri.<sup>48</sup>*

Ose:

*Çamët po iknin posi bakëti,  
pleqtë ishin xathur, grat pa shami,  
në duart e tyre mbanin ca sabi,  
jene të pa bukë ecnin nëpër shi,  
vdisnin nëpër udhë, aman jarabi!<sup>49</sup>*

Presion i llogaritur mirë nga pushtuesi ishte edhe çarmatosja e popu-

47 *Epikë historike kosovare*, f. 91.

48 *Këngë popullore nga Çamëria*, f. 708.

49 *Po aty*, f. 759.

llsisë shqiptare, sepse në atë mënyrë e thenin tehun e rezistencës, e armatosnin popullin e vet, mbillnin ndjenjen e pasigurisë dhe cenonin dinjitetin njerëzor e kombëtar. Dhuna që ushtrohej në këtë mënyrë ishte formë e përshtatshme e ndjekjes së popullatës së padëshiruar për push-tuesin. Efekti i tillë i çarmatimit të shqiptarëve duket se është studiuar mirë edhe për arsye të kultit të posaçëm të tyre ndaj armëve, prandaj, si i tillë është shfrytëzuar vazhdimisht e po shfrytëzohet edhe sot në presi-onin që po ushtron Serbia ndaj shqiptarëve në Kosovë, si shtet më policor në botë, në ekspeditat, që kanë të njëjtin qëllim si para një shekulli.

*Na mur shkjaun e haj medet,  
na i mloth armët rajës po va jep,  
po va jep, po i shkrun' komitë,  
me vra shqiptart e me i plaçkitë.<sup>50</sup>*

Rezistenca e organizuar e trevave shqiptare të pushtuara del më e plotë edhe nga këngët që u këndohen personaliteteve të dalluara nga gjithë shtrirja e botës shqiptare. Në këto këngë paraqiten trimëritë, sakrificat, flijimet dhe roli i tyre në rezistencën kolektive e kombëtare. Është shumë i madh numri i këtyre personaliteteve dhe i këngëve për to, që përbëjnë një pjesë të historisë sonë të lavdishme, të kënduar në vargje, por edhe të tragjedisë kombëtare.

Vështrimi ynë del, ndoshta, pak i ngarkuar me vargje me një mori shembujsh, të cilët kanë kronologjinë e vet dhe venë në dukje kon-tinuitetin e realitetit të hidhur, që ende po vazhdon.

Këngët popullore historike me tematikë të luftërave për mbrojtjen e tërësisë kombëtare e tokësore shqiptare, me aktualitetin e tyre të për-hershëm bënë që vazhdimisht të jenë të pranishme, por edhe të ndikojnë në ruajtjen dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe në gatishmërinë e popullit për luftë e flijime të reja për liri e pavarësi. Ky cikël, nëse mund ta quajmë kështu, fatkeqësisht, mbetet i hapur për kah vazhdimësia krijuese, ngase edhe rrethanat e aktualitetit politik, kombëtar e territorial janë të njëjta me ato të së kaluarës, duke u përsëritur historia, por edhe rreziqet për ndonjë kah edhe më tronditës. Kështu, vazhdimësia e këtij realiteti politik le udhë për kontinuitet të krijimtarisë epike gojore me tematikë të tillë.

Historia, si mësuese e jetës, sipas latinëve, dhe epika historike, si transponim i saj, si mësim, përvojë e shkollë për të tashmen e të ardhsh-men, i vënë në dukje aktivitetet e koordinuara antishqiptare të shteteve

<sup>50</sup> *Epikë historike kosovare*, f. 372.

ballkanike, me bekimin edhe të disa shteteve evropiane, që e kanë sjellë në këtë situatë kombin tonë me një prani të theksuar edhe sot të synimeve e pretendimeve të vjetra.

*Fazli Syla*

### LA DEFENSE DE L'ENSEMBLE NATIONAL ALBANAIS D'APRES LES SHANTS HISTORIQUES

Le passé du peuple albanais est imprégné de nombreux efforts et de combats continuels pour sauvegarder l'ensemble national et territorial de différents occupants. Notons, en particulier, les envahissements des pays voisins qui continuent encore.

Les événements pour la défense des terres albanaises sont transposés d'une manière artistique dans les chants folkloriques de sujet historique, qui ont formé ainsi une matière précieuse de l'héritage spirituel du peuple albanais.

On chante sur les personnalités distinguées et les luttes de différentes périodes de l'histoire. Les chants de sujet historique notent le comportement sauvage des occupants et la résistance des Albanais contre le démembrement de leurs terres ainsi que leurs efforts continuels pour le rattachement national.